

**AKTI I THEMELIT TË SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
ZADRIMA AGRIKULTURE SHPK**

Sot, me datë 21.04.2022, Ortaku themelues, i vetem :

**BASHKIA VAU DEJËS**, person juridik publik, organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me adresë të regjistruar, Rruga“ Qafa e Gurit”Vau Dejës, përmes këtij akt themelimi.

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë**

**Neni 1**

**Themelimi, Themeluesit, Emri**

Sot me datë 21.04.2022, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Zadrime Agrikulture”shpk, në përputhje me ligjin nr 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar ( këtu e më poshtë Shoqëria)

Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar( shpk)

Themeluesit e shoqërisë “ZadrimeAgrikulture” shpk, janë :

Bashkia Vau Dejës, me Nipt K567050070, me kryetar Z. Mark Babani, me adresë “ Rruga Qafa e Gurit” Vau Dejës

**Neni 2**

**Objekti i Shoqërisë.**

Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, grumbullimi dhe ruajtja e produkteve bujqësore të agrikulturës, agropërpunimit .

**Neni 3**

**Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

**Neni 4**

**Selia e Shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Zadrime Agrikulture”shpk, ka selinë e saj pranë zyrave të Bashkisë Vau Dejës, Rruga Qafa e Gurit, Ndërtesa nr 9 , hyrja nr 1 , Lac Fshat , zk 8598,Vau Dejës.

**Kreu II**

## **Kapitali i shoqërisë.**

### **Neni 5**

#### **Kapitali**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 ( njëqind) lekë. Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si vijon:

Lloji i kontributit është në para ne vlerën 100(njëqind) lekë, 1 kuote, që përbën 100 % vlerën e kapitalit themeltar të shoqërisë, që i përket Bashkisë Vau Dejës.

### **Kreu III**

#### **Administratori i shoqërisë**

### **Neni 6**

#### **Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit.**

Asambledhja e përgjithshme zgjedh administratorin e shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare (pesë), në pajtim me parashikimet e Ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 ,i ndryshuar.

Administratori i pare i shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare është Sabah Ymeri.

### **Kreu IV**

#### **Dispozitat përfundimtare**

### **Neni 7**

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë percaktuar dhe inicialet e emërimit tregtar. Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblese së Përgjithshme, dhe rregullime të tjera do të rregullohen nga Statuti I Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",i ndryshuar si dhe Ligji 9723,datë 03.05.2007"Për QKB",i ndryshuar.

Ky akt themelimi është përpiluar në pesë kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

VauDejës me datë 21 . 04 .2022

**THEMELUES**

**BASHKIA VAU DEJËS**

**Mark Babani**

